| <b>1. Pasqyra e auditimeve të kryera dhe ndryshimi nga plani vjetor i auditimit, duke theksuar arsyet e ndryshimit ose moskryerjes së auditimeve të planifikuara</b>                                                                                                                                                                                                                                      |    |
| Thekso të gjitha auditimet e kryera në periudhën raportuese me të gjeturat dhe rekomandimet, dhe drejtimi i shkurt për secilin auditim.                                                                                                                                                                                                                                                                   |    |
| <b>1.1 Emërtimi i auditimit: Aktivitetet e zhvilluara në Zyren e prokurimit.</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |    |
| Të gjeturat:<br><b>Të gjeturat kryesore janë paraqitur në vazhdim:</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |    |
| <b>1.-Plani vjetor i prokurimit për vitin 2020.</b><br>-Gjatë testimeve të bëra kemi konstatuar se Drejtoria e prokurimit ka përgatitur planin dinamik të prokurimit për përmbushjen e nevojave të domosdoshme dhe ka dorëzuar në APP,në përputhje të nenit 8 të LPP-së Nr.04/L-042.<br>-Aktivitetet e Drejtorisë së prokurimit zhvillohen në bazë të planifikimit të prokurimit për vitin aktual fiskal. |    |
| <b>2.Procedurat e prokurimit;</b><br>- Zyra e prokurimit gjat procesit të prokurimit për vitin fiskal 2020 kryesisht ka zbatuar procedurat e prokurimit sipas Ligjit për prokurim publik në Kosovë Nr.04/L-042 , plotësimi i                                                                                                                                                                              |    |

Ligjit 04/L-237 datë 17.04.2014, plotësimi i Ligjit 05/L-068 datë 06.01.2016 dhe plotësimi i Ligjit 05/L-092 datë 01.03.2016.

### **3. Formimi i komisioneve;**

- Komisioni i hapjes së ofertave gjenerohet nga aplikacioni i "e" prokurimit nga numri i zyrëtarëve të mundshëm (30) të cilët janë në sistem të aplikacionit .Komisioni përbëhet prej dy anëtarëve.
- ZKA ka bërë formimin e komisioneve për vlerësimin e ofertave.
- Ekzistojnë vendimet e marra nga ZKA në bazë të nominimit nga Drejtori i prokurimit për emërimin komisioneve për vlerësimin e ofertave .
- Ekzistojnë deklaratat e nënshkruara të anëtarëve të komisioneve nën betim.

### **4. Kontratat;**

- Në dosjet e prokurimit të cilat ishin pjesë e mostrave të cilat i kemi marrë për testim kemi konstatuar se kontratat janë dhënë në bazë të kriterit qmimit më të ulët ashtu siq janë paraparë edhe në tenderet e shpallura.
- Operatorë janë njohëtur mbi kontratën e dhënë në përputhje me nenin 41 të LPP-së Nr.4/L-042 dhe plotësimi i Ligjit 05/L-092 datë 19.02.2016.
- Nënshkrimi i kontratës është bërë nga Drejtori i licencuar i prokurimit dhe në disa raste Zyrëtar i autorizuar i licensuar, në përputhje me nenin 26 të LPP.Nr.04/L-042 dhe plotësimi i Ligjit 05/L-092 datë 19.02.2016.

### **5. Përshkrimi i vendeve të punës dhe trajnimet e stafit të prokurimit si dhe licencimi;**

- Në bazë të testeve të kryera konstatohet se :
- Ekziston sistematizimi i vendeve të punës.
- Ekziston përshkrimi i vendeve të punës.
- Gjat vitit 2020 Zyra e Prokurimit ka pasur 3 zërëtarë , dy zyrëtar kanë ndjekur trajnimet dhe licensimi i tyre është bërë në fillim të viti 2021. Ndërsa Drejtori i Prokurimit dhe stafi tjetër posedojnë licensën e nevojshme , neni 25 i ligjit LPP Nr.04/L-042 dhe plotësimi i Ligjit 05/L-092 datë 19.02.2016.

**Rekomandimet :**(përshkruaj rekomandimet, të cilat kanë të bëjnë me të gjeturat e përshkruara)  
**Rekomandimi Nr.1.**

**Rekomandojmë menaxhmentin që në të ardhmen gjat shpalljes së tendereve të specifikohen qartë rrugët apo segmentet rrugore sipas emërtimeve të tyre e sidomos të behet paramasa dhe parallogaria për sejcilin segment të këtyre rrugëve.**

Rekomandimi pjesërisht është implementuar, prandaj ripërsëritet.

#### **Rekomandimi Nr.2.**

**Me rastin kur projekti është i paraparë për furnizime, vendosje apo instalime (vendosja e kamerave në qytet) përpos specifikacionit teknik për mallrat apo asetet të bëhet edhe projekti për vendosjen e këtyre paisjeve lokaliteti (rruga apo pozita e vendosjes).**

Rekomandimi pjesërisht është implementuar, prandaj ripërsëritet.

Përmbajtja e shkurt drejtuese (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

## 2. FUSHËVEPRIMI DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

**2.1-Objektivat e Auditimit:** kanë për qëllim për të siguruar se:

- Ka një plan vjetor të prokurimit;
- Zbatohen procedurat e prokurimit në bazë të Ligjit për prokurim publik në Kosovë Nr.04/L-042 ,plotësimi i Ligjit 04/L-237 datë 17.04.2014,plotësimi iLigjit 05/L-068 datë 06.01.2016 dhe plotësimi i Ligjit 05/L-092 datë 01.03.2016.
- Vendimet për formimin e komisioneve;
- Kontratat për punët e kontraktuara dhe menaxhimi i tyre;
- Përshkrimi i vendeve të punës dhe trajnimet e stafit të prokurimit si dhe licensimi.

### 2.2 Fushëveprimi i auditimit;

Zyra e prokurimit Komuna –Shtime

Periudha : Prej 01.01 deri më 31.12 2020

### 1.2 Emërtimi i auditimit: **Menaxhimi i pasurisë**

Të gjeturat:

**Të gjeturat kryesore sipas objektivave të caktuara të paraqitura në këtë raport janë:**

**Objektiva 1. Për të siguruar se procedurat e menaxhimit të pasurisë jan themeluar si duhet dhe konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.**

Gjatë rishikimit dhe testimeve të bëra ne gjetëm se:

- Ekzistojnë procedurat për menaxhimin e pasurisë si që janë: Ligji mbi menaxhimin e financave publike Nr.03./L-48 me plotësim ndryshimet; Ligji mbi menaxhimin e financave të pushtetit lokal 03/L-49 si dhe Rregullorja e MF për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore Nr.02/2013 si dhe
- Në përgjithësi zbatohen procedurat e përcaktuara.

**Objektiva 2. Për tu siguruar se bëhet evidentimi i rregullt i pasurisë së blerë.**

Nga testimi i bërë kemi konstatuar se:

- Ekziston regjistri kryesor i regjistrimit të pasurisë;
- Pasuritë në vlerë mbi 1000€ regjistrohen në SIMFK(Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës) ndërsa ato nën 1000€ nga vitit 2019 janë regjistruar në regjistrin kontabël "e pasuria" të paraparë me nenin 6, të rregullores 02/2013. Kurse për regjistrimin e pasurive të trashëguara, donacionet dhe blerjet e më hershme, zyrtarët e Komunës nuk kanë qasje për ta bërë bartjen e këtyre pasurive në regjistër kontabël "e pasuria", prandaj regjistrin e vjetër të këtyre pasurive Komuna e ka dërguar në Ministrinë e Administratës Publike për të i bartur në regjistrin kontabël "e pasuria" pasi qe vetëm ata kanë qasje në këtë aplikacion për bartjen e evidencës së vjetër dhe këto bartje janë bërë gjatë vitit 2019. Regjistrimi i pasurisë mbi 1000€ bëhet duke u bazuar në shpenzimet e paraqitura në SIMFK sipas CPO-ve për pagës, ndërsa për pasurit nën 1000€ regjistrimi bëhet përmes aplikacionit "e-pasuria" me rastin e pranimi të pasurisë në depo me CPO me faturë. Me rastin e vënies në përdorim të pasurisë, apo pasurisë ekzistuese, pasurisë i vendoset bar kodit identifikues i gjeneruar nga aplikacioni "e pasuria", ky kod këtë vit i është vendosur pasurive në të gjitha institucionet e Komunës;

-Zhvlerësimi i pasurisë bëhet një herë në vit sipas Rregullores së MF për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore Nr.02/2013.

### **Objektiva 3. Për të siguruar sa bëhet inventarizimi vjetor i pasurisë.**

Nga testimi i bërë kemi konstatuar se:

-Kryetari ka marrë vendim nr.02/598 datë 29.10.2020 për Inventarizimin e Pasurisë për vitin 2020 në komunën e Shtimes. Me këtë rast me vendime të veçanta janë formuar edhe komisionet për inventarizim në nivel të programeve dhe organizimit të komunës si që janë: Administrata e përgjithshme komunale; QKMF "Vezir Bajrami"; Qendra për punë sociale; Shërbimet Rezidenciale; si dhe për të gjitha programet buxhetore në Arsim

-Komisioni për inventarizimin e pasurisë, ka kryer inventarizimin e pasurisë në të gjitha njësitë buxhetore.

-Komisioni për inventarizimin në njësitë buxhetore ku është kryer inventarizimi ka kryer regjistrimin edhe të pasurisë të pa përdorur dhe i ka dorëzuar Komisionit të vlerësimit të pasurisë që të vlerësohen dhe të i dërgohen ZKA-s për marrjen e vendimit për administrim të më tejme.

- Komisioni për vlerësimin e pasurive, nuk ka bërë vlerësimin vjetorë si dhe të pasurive: të cilat nuk kanë vlerë financiare por ende janë në përdorim, pasurive të dëmtuara (jashtë përdorimit), pasurive për të cilat ka kërkesa për tjetërsim.

-Në evidencën e regjistrit kryesor janë të evidentuar dhe ngarkuar personat përgjegjës për ruajtjen dhe shfrytëzimin zyrtar të pasurisë.

### **Objektiva 4. Për të u siguruar se zbatohen procedurat e barazimit.**

Gjatë testimit se a ka barazim në mes të evidencës së pasurisë sipas evidencës kontabël dhe inventarizimit vjetor të pasurisë kemi vërejt se:

- Po, rregullisht bëhet barazimi dhe regjistrimi i pasurive mbi 1000€ në regjistrin e pasurisë sipas shpenzimeve në SIMFK;

-Pasi që pasurit nën 1000€ nuk regjistrohen në regjistrin e pasurive të SIMK-së por në aplikacionin "e-pasuria", ne kemi vërejt se gjatë testeve të kryera ka raste kur pasurit e blera me vlerën nën 1000€ nga kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime janë proceduar për pagesë pa u regjistruar në depo, pagesa është proceduara vetëm me konfirmim nga menaxheri i kontratës për pranimin e pasurisë por jo edhe me raportin e gjeneruar nga aplikacioni "e-pasuria"-depo për pranimin në posedim të pasurisë, pra pa u regjistruar në depo janë bërë pagesa;

-Gjatë testimit se a ka barazim në mes të evidencës së pasurisë sipas evidencës kontabël dhe inventarizimit dhe vlerësimit vjetor të pasurisë nën 1000€ zyrtari për menaxhimin e pasurisë ka hasur në vështirësi të bëjë barazimin në mes të inventarizimit vjetor të komisionit për inventarizim dhe regjistrin të pasurisë për arsye se komisioni i vlerësimit nuk ka përfunduar punën e tij duke dorëzuar raportin përfundimtar të vlerësimit të pasurisë, përkundër që komisioni për inventarizimin vjetor dhe zyrtari i pasurisë i kanë dorëzuar raportin e inventarizimit vjetor 2020. Pra vlera neto në libra e pasurisë nën 1000€ është sipas zhvlerësimit automatik periodik e jo e barazuar edhe me raportin nga komisioni mbi vlerësimin vjetor të pasurisë sipas rregullave në fuqi.

**Rekomandimet:****Rekomandimi Nr.1**

Komisioni për inventarizimin e pasurisë për vitin 2020 ka kryer inventarizimin e pasurisë së Komunës, por Komisioni për vlerësimin e pasurive, nuk ka bërë vlerësimin e pasurive: të cilat nuk kanë vlerë financiare por ende janë në përdorim, pasurive të dëmtuara (jashtë përdorimit), pasurive për të cilat ka kërkesa për tjetërsim, edhe pse ZKA ka formuar me kohë këtë Komision, prandaj ne rekomandojmë që; Menaxhmenti të marrë masat e nevojshme që ky Komision të kryej punën për vlerësimin e pasurisë, për të cilën është autorizuar me vendimin Nr.02/600 të datës 29.10.2020.

**Rekomandimi Nr.2**

Ne rekomandojmë menaxhmentin që me rastin blerjeve apo pranimi të pasurive nën 1000€ të mos procedohen për pagës pa qenë të pranuar në depo dhe regjistruara në aplikacionin "e-pasuri" pasurit e pranuar, gjithashtu edhe raporti nga komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë të jetë gatshëm me rastin e përfundimit të vitit fiskal që do të prezantonte gjendjen e pasurisë në përdorim dhe posedim nga komuna edhe pas lëvizjeve të pasurisë brenda organizatës.

Përmbajtja e shkurt e drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

**2. FUSHËVEPRIMI DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT**

**2.1 Objektivat e auditimit ishin:** Për të rishikuar sistemin e kontrollit të brendshëm të menagjimit të pasurisë dhe për të dhënë siguri të arsyeshme se:

2.1.1. Procedurat e menaxhimit të pasurisë janë themeluar si duhet, sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

2.1.2. Që të ketë procedura të barazimit, të ketë gjurmë, dhe janë të miratuara nga niveli i duhur i menaxhmentit.

2.1.3 Të ipet një opinion për përshtatshmërinë dhe efikasitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

2.1.4 Të ipen rekomandime për përmirësimin nëse ka nevojë dhe për të siguruar se është arritë marrëveshje për to.

**2.2 Fushëveprimi i auditimit :**

-Rishikimi i menagjimit të pasurisë për vitin 2020.

**1.3 Emërtimi i auditimit: Të hyrat vetanake nga bashkëpagesat për shërbimet në shëndetësi**

Të gjeturat:

**Të gjeturat kryesore sipas objektivave të caktuara të paraqitura në këtë raport janë:**

-Ekzistojnë procedurat e krijimit të të hyrave vetanake dhe janë themeluar si duhet dhe konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi për menaxhimin me të hyrat vetanake si që janë: Ligji mbi menaxhimin e financave publike Nr.03./L-48 me plotësim ndryshimet; Ligji mbi menaxhimin e financave të pushtetit lokal 03/L-49; Rregulla financiare 03/2010 për të

hyrat vetanake- Ministria e Financave; Udhëzimi Administrativ 04/2007 dhe Udhëzimi Administrativ 02/2015 i Ministrisë për Shëndetësi; si dhe Rregullorja komunale nr. 01-060/01-1933/2 datë: 20.01.2021 për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2021;

-Rregulla financiare e MF nr.: 03/2010 për të hyrat Vetanka neni 13 përshkruan procesin e barazimit me të hyrat veatnak për të gjitha institucionet që mbledhin të hyra financiare veatnake;

-Për inkasimin e pagesave nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore përdoren bllokat e dëftesave me numër serik e jo moduli për të hyra në kuadër të Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH);

-Arka furnizohet me dëftesa për inkasim;

-Arka e të hyrave i ngarkon me bllok-dëftesa zyrtarin e autorizuar në sportel, në kujdestari dhe në punkte;

-Të hyrat nga bashkë pagesat janë të evidentuara në mënyrë të saktë, ashtu që shihet qartë niveli i grumbullimit të tyre;

-Dëftesat për inkasim i lëshohen pacientëve të cilët janë të obliguar të bëjnë pagesat ndërsa për pacientët të cilët lirohen nga këto pagesa nuk iu lëshohet fletëpagesa gjë që parashihet sipas Udhëzimit Administrativ Nr.04/2007 neni 3 pika 3.8, më arsytim për racionalizimin e shpenzimeve për furnizimin e këtyre dëftesave;

-Çmimoret për shërbimet e kryera janë të ekspozuara në vende adekuate, ku ka një transparencë të plotë;

-Punëtori i ngarkuar me dëftesa, pas përfundimit të orarit të punës, i rikthen te arkatari i të hyrave dëftesat e plotësuara bashkë me paratë e inkasuara, por nuk ka barazim mes vizitave të pacienteve dhe inkasimit;

-Arkatarin e të hyrave përpilon ditarin e arkës dhe të hyrat e inkasuara për çdo ditë i deponon në llogarin e vetme të thesarit në Bankën Qendrore përmes institucioneve financiare të licencuara;

-Në përgjithësi krijimi i të hyrave vetanake në QKMF-në e Shtimës, është në harmoni me ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret në fuqi;

-Ka një evidencë të qartë të procedurave dhe sistemit të inkasimit të të hyrave prej furnizimit të dëftesave e deri te dorëzimi i parave në bankë. Gjatë testimeve të kryera nga AB kemi gjetur se ka përputhshmëri në total në mes të parave të inkasuara dhe të dorëzuara në Bankë nga QKMF si dhe parave të arritura dhe të evidentuara në llogarinë Komunale;

-Gjithashtu barazimi i paraparë formal mujor është kryer për muajin Janar-Maj 2021

Në përgjithësi krijimi i të hyrave vetanake në QKMF-në, në Shtime është në harmoni me ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret në fuqi.

**Rekomandimet:****Rekomandimi Nr.1**

Edhe pse ka një sistem intern të evidencës së inkasimit të të hyrave vetanake i përdorur para zyrtarizimit të Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH), rekomandojmë që edhe për inkasimin e të hyrave vetanake të përdoret moduli i të hyrave nga pagesat e pacienteve në kuader të Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH) i cili do të gjeneronte edhe fletpagesat për secilin pacient përfshirë edhe ato me vlerën zero(0€) .

Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

**2.OBJEKTIVAT DHE FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT****2.1Objektivat e auditimit:**

1.Për të rishikuar sistemin e kontrollit të brendshëm të krijimit të të Hyrave vetanake dhe për të dhënë siguri të arsyeshme se:

- 1.1. Procedurat e krijimit të të hyrave janë themeluar si duhet dhe konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi;
- 1.2. Që të ketë procedura të barazimit, të ketë gjurmë, dhe janë të miratuara nga niveli i duhur imenaxhmentit;
- 1.3. Të ipet një opinion për përshtatshmërinë dhe efikasitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
- 1.4. Të ipen rekomandime për përmirësim nëse ka nevojë dhe për të siguruar se është arritë marrëveshje për to.

**2.2Fushëveprimi i auditimit:**

Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale; QKMF.

-Periudha: 01.01.2021 deri 31.05.2021

**1.4 Emërtimi i auditimit: Të hyrat vetanake nga tatimi në pronë.**

Të gjeturat:

**Të gjeturat kryesore sipas objektivave të caktuara të paraqitura në këtë raport janë:**

**Objektiva 1- Për të siguruar se njësia e TP ka krijuar bazën e vlerësimit të dhënave të TP.**

- Gjat intervistave të kryera me stafin e zyrës së TP si dhe gjat testimeve të kryera kemi konstatuar se ekziston bashkëpunimi me Drejtorinë e Urbanizmit dhe Kadastrit, por ky bashkëpunim duhet të intensifikohet edhe më shumë pas hyrje në fuqi të ligjit të ri Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.
- Regjistrimi i pronave-objekteve është kryer nga ana e anketuesve në bazë të vizitave në teren. Gjat vitit 2021 deri me 31.08.2021 janë regjistruar 57 prona të reja sipas rexhistrit nga PROTAX. Ndërsa rexhistrimi dhe procesimi i ndryshimeve në parcel bëhet gjdo vit përmes pranimit të të dhënave nga Agjensioni Kadastral duke migruar informatat nga Agjensioni në aplikacionin PROTAX.
- Me rastin e testimeve kemi hasur në raste ku është bërë regjistrimi i obliguesit të TP për pronën e pa luajtshme objektin ndertimor ndërsa për pronen rezidenciale parcelen, nuk është bërë regjistrimi ose anasjelltas.

**Objektiva 2 - Për të siguruar se njësia e TP ka bërë verifikimin, regjistrimin dhe vlerësimin e 20% të pronave të tatueshme-Ligji Nr.06/L-005.**

- Zyra e TP ka hartuar planin vjetorë për verifikimin e 20% e pronave të regjistruara - Ligji Nr.06/L-005.
- Zyra e tatimit në pronë për obliguesit tatimor ka përgaditur 5,108 fatura për vitin 2021, nga të cilat ka planifikuar që 20% të tyre të bëjë verifikimin e këtyre pronave për të përmbushur obligimin në bazë të Ligjit Nr.06/L-005 e që i bie të bëjë verifikimin e 1,022 pronave. Gjat kësaj periudhe kjo zyre ka bërë verifikimin e 97 pronave që e shprehur në përqindje është 9.45 % nga ajo e planifikuar.

**Objektiva 3 - Për të u siguruar se: Kalkulimet e faturave janë të sakta dhe të shperndara me kohë.**

- Përgaditja e faturave për obliguesit tatimor është bërë sipas Ligjit Nr. 06/L-005 Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, U.A nr.08/2019 dhe rregullorës së K.Komunal mbi Tatimin në Pronë Npi – 01/267, Datë: 24.11.2020
- Gjat testeve të kryera kemi hasur në disa gabime, konkretisht me rastin e zbritjes së bazës tatimore për vlerën prej 15,000€ për objektet primare të banimit, kjo vlerë është zbritur në mënyr automatike përmes Aplikacionit Protax sipas atributit “nga i pari” që i bjen se në objektin që është rexhistruar i pari bëhet zbritja prej 15,000€ pa marrë parasysh statusin e objektit. Kjo situat vazhdon të jetë e njëjt për deri sa tatimpaguesi nuk njofton zyrën e tatimit në pronë konform Nenit 11 të Ligjit 06 L-005 për pronen primare të banimit. Kështu që në këto raste ndryshon vlera e faturës.
- Nga mostrat e marrura për testim nuk kemi hasur në gabime gjat kategorizimit të pronave, mospërputhjes së kategorive në aplikacionin POTAX të TP dhe rregullores komunale.
- Zyra e TP për vitin 2021 ka bërë përgaditjen e 5,108 faturave për obliguesit tatimor dhe ka shpërndarë ato në vlerë prej 266,068.39€. Të gjitha faturat i janë dorëzuar PTK-së me kohë për shpërndarje dhe PTK ka dorëzuar raportin mbi shpërndarjen e tyre. Nga ky raport shihet se PTK ka shpërndarë 5,107 fatura ose 99.99%. Nuk është dorëzuar 1 fatur nga arsya se personat në fjalë kanë ndërruar vendbanimin.

**Objektiva 4 - Shqyrtimi i ankesave të parashtruara nga tatim paguesit.**

- Nga protokoli del se Zyra e TP ka pranuar 69 ankesa deri më 31.08.2021, njera ankes është refuzuar, një është tërhequr nga tatim paguesi, ndërsa 67 tjera janë aprovuar.
- Komuna ka shqyrtuar ankesat e aprovuara ndërsa për ankesën e refuzuar ka për Departamentin e Tatimit në Pronë në MF. Ankesa e refuzuar ka të bëjë me kontestimin e fatures tatimore e që nuk ka pasur arsye, ndërsa ankesat e aprovuar ka të bëjë me identifikimin e gabimit në vlersimin e tërë parcelës si oborrë e jo vetëm pjesa e shtëpis si oborr. Vlen të ceket se ankesa të kësaj natyre mund të jen më të mdhaja për arsyes të mos procesimit në PROTAX të ndarjeve në parcela dhe identifikimin e tatim paguesit. Ndërsa për TP për objektet nuk ka pasur asnjë ankesë.
- Zyra e Tatimit në pronë i ka njoftuar ankuesit me vendimin si dhe janë procesura në Protax ndryshimet sipas vendimit.

**Objektiva 5 - Për të siguruar se grumbullimi i të hyrave TP është realizuar sipas buxhetit të planifikuar.**

- Komuna e Shtimës për vitin 2020 ka vlersuar-faturuar të hyrat vetanake nga TP në

objekte Komuna e Shtimës për vitin 2021 ka vlersuar-faturuar të hyrat vetanake nga TP në objekte 153,983€, ndersa për parcela 112,085.39€. Gjithësejt 266,068.39€.

- Të hyrat e faturuara për vitin 2021 nga TP në objekte kanë qenë 153,983€, ndersa ato të inkasuara për periudhen fiskala prej 01.01 deri me 31.08.2021 kanë qenë 58,773.07€ apo 38.17% ndersa për parcela faturimi ishte 112,085.39€ i faturuar, ndersa realizimi ishte 28161.50€ apo 25.13%. Pra në total realizimi TP në raport me vlersimin/faturimin është 33% apo në shumë 86,934.57€ inkasim nga faturimi/vlersimi për vitin 2021, duke mos përfshir inkasimin nga interesi dhe denimet.
- Të hyrat e planifikuar me buxhet për vitin 2021 nga TP janë 227,910€, ndersa ato të inkasuara për periudhen fiskala prej 01.01 deri me 31.08.2021 janë 179,699€ apo 75.58%. Por në këtë inkasim hynë edhe pagesat e borgjeve të vjetra. Nga këto të hyra 90,882.03€ apo 50.57% i takojnë borgjeve për vitet paraprake që me 31.08.2021 në total arrinë në vlerë prej 735,029€ e që reflektojnë zvoglim të të Arkëtueshmeve në raport me periudhen e njëjtë të vitit paraprak në shumën prej 64,919.03€ apo 8.11% e që ky trend duhet të jetë i vazhdueshëm për periudhat e ardhshme.
- Komuna si masë për inkasimin e këtyre borgjeve ka aplikuar dhënjen e vërtetimeve me rastin e kryerjes së disa shërbimeve si regjistrimi i pronave, regjistrimi i vetuarave etj. Në gjatë testimeve nuk kemi hasur ku zyrtarët e TP të kenë dhënë vërtetime për miratimin e borgjit ndersa tatim paguesi të këtë borgj të pa përmbushur. Masa tjera apo aplikimi i Kapitullit VII të Ligjit 06 L-005 për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara nuk janë zbatuar plotësisht.

Rekomandimet:

#### **Rekomandimi Nr.1.**

-Rekomandojmë ZTP që të monitoron regjistrin e tatimpaguesve pas migrimit të të dhënave nga Agjensioni Kadastral për parcelat dhe të evidentoj ndryshimet e azhuruara për tatimin në parcela. Si dhe të intensifikoj edhe më shumë bashkpunimin me Drejtorin e Urbanizmit Kadastër dhe Gjeodezi, pas hyrje në fuqi të ligjit të ri Nr.06/L-005 për TP për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

#### **Rekomandimi Nr.2.**

Ne rekomandojmë që të shtohet aktiviteti i zyrës së tatimit në pronë për realizimin e planit për verifikimin e objekteve pasi që do të ndikon edhe në përditësimin e të dhënave në regjistrin e tatimpaguesve si dhe inkasimin e tatimit në pronë.

#### **Rekomandimi Nr.3:**

Ne rekomandojmë që zyra e tatimit në pronë të identifikoj tatim paguesit me dy e më shumë prona dhe të informoj tatim paguesit mbi obligimin ligjor që të deklarojnë pronën primare.

#### **Rekomandimi Nr.4:**

-Ne rekomandojmë që në të ardhmen Zyra e tatimit në pronë përpos masave të ndërmarrura, të ndërmerr edhe masa tjera ligjore siq parasheh Kapitullit VII i Ligjit 06 L-005 për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara.

Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

## **2. FUSHËVEPRIMI DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT**

### **Objektivat e auditimit:**

Duke u bazuar në analizat e rrezikut, të testimit të kontrollit të brendshëm në njësinë e tatimit në pronë, në pajtimin e arritur në takimet me udhëheqësin e njësisë së tatimit në pronë dhe njëheri për të siguruar se sistemi i kontrollit të brendshëm i përmbushë në mënyrë adekuate kriteret e nevojshme dhe se kjo njësi ka kapacitet të mjaftueshëm për të ofruar menaxhim të efektshëm dhe efikas kemi përcaktuar objektivat në vijim:

1. Për të siguruar se njësia e TP ka krijuar bazën e vlerësimit të dhënave të TP;
2. Për të siguruar se njësia e TP ka bërë verifikimin, regjistrimin dhe vlerësimin e 20% të pronave të tatueshme;
3. Për të u siguruar se: Kalkulimet e faturave janë të sakta dhe të shperndara me kohë;
4. Për të siguruar se shqyrtimi i ankesave TP është kryer me kohë sipas legjislacionit;
5. Për të siguruar se grumbullimi i të hyrave TP është realizuar sipas buxhetit të planifikuar.

**Fushëveprimi i auditimit:**

- Njësia e tatimit në pronë
- Periudha: 01.01.2021 deri 31.08.2021

**1.5 Emërtimi i auditimit: Menaxhimi i personelit-Sistemi i pagave në Arsim.**

Të gjeturat:

**Të gjeturat kryesore sipas objektivave të caktuara të paraqitura në këtë raport janë:**

**Objektiva 1- Për të u siguruar se regrutimi i stafit është bërë në pajtim me Ligjet në fuqi.**

Gjat intervistave të kryera me stafin e Drejtorisë si dhe gjat testimeve të kryera kemi konstatuar se:

- Inicimi i kërkesës për rekrutim me personel bëhet nga institucioni arsimor në bazë të planeve shkollorë për çdo fillim vit shkollorë si dhe në raste të paparashikuara edhe për zëvendësime të përkohshme;
- Kërkesa për personel miratohet nga Komuna-Drejtoria e Arsimit në komunë e cila edhe iniconë procesin e shpalljes dhe themelimin e komisionit për administrimin rekrutimit;
- Shpallja e konkurseve bëhet në web-page të komunës, linkun qeveritar në Sistemin për Menaxhimin e Burimeve Njerzore(SIMBNJ) për rekrutim si dhe hapësirave të hapura me qasje të publikut në hyrje të institucionit;
- Shpallja e konkursit dhe procesi i përzgjedhjes në përgjithësi bëhet sipas Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 por tek kushtet për pjesëmarrje në konkurs nuk janë të theksuara kriteret e vendit të punës në mënyrë specifike, por vetëm baza ligjore për kriteret e vendit të punës;
- Sipas Statutit dhe akteve ligjore të komunës, Kryetari nxjerr vendime për emërimin e komisioneve sipas përmbajtjes me Udhëzim Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik;
- Në mostrat që kemi testuar kemi hasur se përgatitja dhe testimi kryhet sipas përmbajtjes së Nenit 10, të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik, Komisioni i Përzgjedhjes përgatit testin dhe organizon testin me shkrim dhe intervistat me gojë; si dhe
- Shpallja e rezultateve dhe njoftimi është bërë sipas Nenit 8, të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik

## **Objektiva 2 - Për të u siguruar se pagat e stafit kryhen në pajtim me Ligjin dhe rregulloret në fuqi.**

Gjat testimeve të kryera kemi konstatuar se:

- Për deri sa në vitet paraprake nuk janë lejuar planifikimet e shpenzimeve të parapara me Kontratë Kolektive, nga vit 2021 janë lejuar pjesërisht planifikimi i shpenzimeve të parapara me kontratë, por jo edhe shpenzimet për shujta dhe udhëtim të Personeli si dhe obligimet përmbartimore nga vitet paraprake;
- Janë të mjaftueshme për planifikimet e vitit 2021 pasi që sipas ecures së shpenzimeve deri me tani ka saldo pozitive buxhetore financiare, por nuk i përfshijnë edhe obligimet përmbartimore nga vitet paraprake;
- Personeli paguhet sipas normës që e mbanë dhe çdo ndryshim reflekton edhe ndryshimin e kontratës së punës
- Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.10/2015 për Kontratën e Punës për Mësimdhënës të Arsimit Parauniversitar është e definuar paga bazë dhe kategoritë tjera në kuadër të pagës për mësimdhënës;
- Nga menaxhmenti i shkollës monitorohet vijueshmëria e stafit në punë në mënyrë manuale dhe jo plotësisht përmes Sistemit të Menaxhimit të Pranisë në punë-svmp.rks-gov.net edhe pse tani janë të vendosura pajisjet në disa prej shkollave dhe pritjet të funksionalizohen plotësisht dhe të kyqen në rrjetin qeveritar;
- Çdo fillim muaji dorëzohen raporte në Drejtorin komunal të Arsimit për vijueshmërinë e stafit në muajin paraprak dhe reflekton në paga nëse kemi mungesa pa arsye.

### **Rekomandimet Rekomandimi Nr. 1:**

-Që në përmbajtjen e shpalljes së konkursit për rekrutim me personel tek pjesa kushtet për pjesëmarrje në konkurs të vendosen kriteret për atë vend pune e jo vetëm baza ligjore për atë vend pune.

### **Rekomandimi Nr. 2:**

-Duhet të bëhet përpjekje që të përfshihen në planifikimet buxhetore edhe shpenzimet e ndikuara nga Kontrata Kolektive që mos të shkaktojnë obligime të cilat do të ekzekutoheshin me vendime Gjyqësore;

### **Rekomandimi Nr. 3:**

-Duhet të funksionalizohet rrjeti i internetit dhe aplikacioni qeveritar Sistemi i Menaxhimit të pranisë në punë-svmp.rks-gov.net për të pasur një evidencë formale dhe të saktë për vijueshmërinë dhe praninë në punë të personelit Arsimor.:

Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

## **2. FUSHËVEPRIMI DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT**

Duke u bazuar në analizat e rrezikut, të testimit të kontrollit të brendshëm në Drejtorin e Arsimit dhe Shkollat, në pajtimin e arritur në takimet me udhëheqësen e Drejtoris së Arsimit dhe njëherit për të siguruar se sistemi i kontrollit të brendshëm i përmbushë në mënyrë adekuate kriteret e nevojshme dhe se kjo Drejtori ka kapacitet të mjaftueshëm për të ofruar menaxhim të efektshëm dhe efikas kemi përcaktuar objektivat në vijim:

1. Për të siguruar se rekrutimi i stafit është bërë në pajtim me Ligjet në fuqi; si dhe
2. Për të siguruar se pagesat e stafit bëhen në pajtim me Ligjin dhe rregulloret në fuqi.

### **Fushëveprimi i auditimit:**

- Periudha: 01.01.2021 deri 30.09.2021

**1.6 Emërtimi i auditimit: Subvencionet, viti 2021**

Të gjeturat:

**Të gjeturat kryesore sipas objektivave të caktuara të paraqitura në këtë raport janë:**  
**Objektiva 1- Për të siguruar se ndarja e Buxhetit të Komunës për subvencione për vitin 2021 është bërë në pajtim me Ligjet në fuqi.**

Gjat intervistave të kryera me stafin e Drejtorive dhe Sektorëve si dhe gjat testimeve të kryera kemi konstatuar se:

- Se ndarja e Buxhetit të Komunës për subvencione për vitin 2021 është bërë në pajtim me Ligjet në fuqi dhe udhëzimet buxhetore si që janë: ligjit nr. 03/I-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr.03/I-221, nr.04/I-116, nr. 04/I-194, nr. 05/I-063, nr. 05/I -007 si dhe udhëzimet buxhetore nga Ministra e Financave Punës dhe Transfereve përmes Qarkoreve buxhetore për planifikimin e buxheteve komunale, Rregullorja MF-Nr-04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Rregullorja komunale 01 Nr.06/570-60 e datës 30.03.2012 me plotësim ndryshimi sipas Vendimit Npi-01/84 me Nr.01-060/01-7137/21, datë 31.03.2021; si dhe Rregullorja komunale sipas Vendimit npi. 01/227 me Nr. 01-060/01-24495/17 datë 16.08.2021 për Aprovimin e Rregullores Komunale për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve, si dhe Rregulla Financiare e MF Nr.01/2013MF për shpenzimin e Parave Publike;
- Se planifikimi i ndarjeve të buxhetit komunal bëhet në drejtori-programe buxhetore dhe sektor që kanë funksion mbështetjen me subvencione të kategorive të qytetarëve-Subvencione për Entitet Jo Publike dhe aktivitete e Organizatave Jo Qeveritare- Subvencione për Entitetet Publike;
- Se ndarjet buxhetore në Subvencione janë pjese e debateve publike mbi buxhetin me palët e interesit gjatë procesit të Aprovimit të buxhetit komunal; si dhe
- Buxheti komunal është publikuar dhe është pjesë e Ligjit nr. 08/I-016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 07/I-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.

**Objektiva 2 - Për të siguruar se procedurat e ndarjes për kategoritë e caktuara bëhen në pajtim me Ligjin dhe rregulloret në fuqi.**

Gjat testimeve të kryera kemi konstatuar se:

- Se procedurat e ndarjes së mbështetjes financiar me subvencione për kategoritë e caktuara janë të përshkruara si në vazhdim: për OJQ-të është Rregullorja MF-Nr-04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, si dhe komuna ka miratuar aktet normative-rregullore për shpenzimet në Subvencione dhe janë: Rregullorja komunale për ndarjen e bursave për Student Nr. 01 Nr.06/570-60 e datës 30.03.2012 me plotësim ndryshimi sipas Vendimit Npi-01/84 me Nr.01-060/01-7137/21, datë 31.03.2021; si dhe Rregullorja komunale sipas Vendimit npi: 01/227 me Nr. 01-060/01-24495/17 datë 16.08.2021 për Aprovimin e Rregullores Komunale për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve;
- Se përveç planifikimit financiar në buxhet Subvencione për Entitet Publike dhe Jo Publike, për vitin 2021 drejtorit nuk kanë përgatitur dhe publikuar Planin Vjetor të mbështetjës financiare për Organizatat Jo Qeveritar sipas Rregullores MF-Nr.04-2017, të Nenit 6 të kësaj rregullore;

- Se për OJQ-t dhe Bursa për Studentet bëhen thirrje publike dhe publikohen shpalljet për mesë së cilave udhëzohen aplikuesit për mundësin e përfitimit të mbështetjes financiare, ndërsa për individ me kërkesa të ndryshme të natyrave ekonomike, sociale dhe shëndetësore nuk aplikohet shpallje por ata aplikojnë me kërkesa individuale dhe varësisht nga kërkesa aprovohet apo refuzohet mbështetja financiare;
- Se nga mostrat që kemi marrë tek përfituesit individual me kërkesa të ndryshme të natyrave ekonomike, sociale dhe shëndetësore kemi hasur rast ku në kërkesa krahas deklaratave të kërkuësve nuk kishte edhe më shumë dëshmi që e vërtetonin gjendjen e deklaruar dhe rekomandim nga drejtoria për arsyeshmërin e kërkesës dhe mundësisë buxhetore në përputhjen me objektivat e drejtorisë para shqyrtimit në komisionin vlerësues të kërkesave për subvencione;
- Se Drejtorit nuk kanë caktuar zyrtar apo ekip për monitorimin e implementimit të projekteve të financuara nga mbështetja financiare me Subvencione edhe pse obligohet sipas Nenit 23 të Rregullores MF Nr-04-2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve;
- Se zakonisht pas mbylljes së vitit aktual fiskal raportohet nga përfituesit e mbështetjes financiare, për vitin 2020 vetëm katër(4) përfitues nuk kanë raportuar nga mbështetja financiare e Drejtorisë së Kulturës për 21 përfitues dhe 3 prej tyre janë financuar përsëri në vitin fiskal 2021, ndërsa në Drejtorin e Shëndetësisë dy(2) nga nëntë(9) përfitues nuk kanë dorëzuar raport e që 1 prej tyre është financuar përsëri në vitin fiskal 2021; si dhe
- Se Neni 36 i Rregullës Financiare të MF Nr.01/2013 për shpenzimin e Parave Publike parasheh kriteret për pagesat e shpenzimeve nga Subvencionet dhe gjitha pagesat janë kryera sipas këtij Neni.

### **Objektiva 3 - Për të sigurua se raportohet sipas kërkesave ligjore.**

Gjatë testimeve të kryera kemi konstatuar se:

- Në kuadër të raporteve periodike financiare raportohet për shpenzimet financiare në Subvencione dhe janë pjesë e raportit që publikohet dhe debatohet në kuvendin komunal;
- Se Zyra e financave përgatit raportet e shpenzimeve financiare me përmbajtje të informatave për nivelin e shpenzimeve financiare sipas burimeve të financimit, kategorive ekonomike të shpenzimeve dhe Drejtorive që për subvencione deri në këtë periudhë janë shpenzuar 141,857€ nga buxheti në dispozicion prej 180,852.22€ apo shprehur në % në nivelin prej 78.44% është shkalla e realizimit të buxhetit;
- Se për vitin 2020 nuk është përgatitur Raport Gjithëpërfshirës vjetor për mbështetjet financiare edhe pse komuna obligohet që sipas Nenit 25 të Rregullores MF Nr-04-2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve të përgatis dhe ta dorëzoj këtë raport tek Zyra e Kryeministrit respektivisht Zyra e Qeverisjes së mirë.

Rekomandimet:

#### **Rekomandimi Nr. 1:**

**Që për vitet vijuese drejtorit duhet të kanë përgatitur dhe publikuar Planin Vjetor të mbështetjes financiare për Organizatat Jo Qeveritar sipas Rregullores MF-Nr.04-2017, të Nenit 6 të kësaj rregullore;**

#### **Rekomandimi Nr. 2:**

**Duhet të bëhet përpjekje që edhe për individ të ketë më shumë dëshmi që e vërtetonin gjendjen e**

deklaruar dhe rekomandim nga drejtoria për arsyeshmërin e kërkesës dhe mundësisë buxhetore në përputhjen me objektivat e drejtorisë para shqyrtimit në komisionin vlerësues të kërkesave për subvencione;

**Rekomandimi Nr. 3:**

Drejtorit duhet caktuar zyrtar apo ekupe për monitorimin e implementimit të projekteve të financuara nga mbështetja financiare me Subvencione sipas Nenit 23 të Rregullores MF Nr-04-2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve;

**Rekomandimi Nr. 4:**

Komuna nuk duhet ti marrë në konsideratë për financim në vitin aktual fiskal me subvencione OJQ-t përfituese të periudhave paraprake e që nuk kanë dorëzuar dhe raportuar për ato mbështetje financiare paraprakisht;

**Rekomandimi Nr. 5:**

Që për secilin vit duhet përgatitur Raport Gjithëpërfshirës vjetor për mbështetjet financiare sipas Nenit 25 të Rregullores MF Nr-04-2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve të përgatis dhe ta dorëzoj këtë raport tek Zyra e Kryeministrit respektivisht Zyra e Qeverisjes së mirë.

Përshkrim i shkurtër i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

**2.OBJEKTIVAT DHE FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT**

**Objektivat e auditimit:**

Duke u bazuar në analizat e rrezikut, të testimit të kontrollit të brendshëm në komunë, në pajtimin e arritur në takimet me udhëheqësen e Drejtorive dhe Sektorve që menaxhojnë me Subvencione dhe njëherit për të siguruar se sistemi i kontrollit të brendshëm i përmbushë në mënyrë adekuate kriteret e nevojshme dhe se kto Drejtori dhe Sektor kanë kapacitet të mjaftueshëm për të ofruar menaxhim të efektshëm dhe efikas kemi përcaktuar objektivat në vijim:

1. Për të siguruar se ndarja e Buxhetit të Komunës për subvencione për vitin 2021 është bërë në pajtim me Ligjet në fuqi.
2. Për të siguruar se procedurat e ndarjes për kategoritë e caktuara bëhen në pajtim me Ligjin dhe rregulloret në fuqi. Si dhe
3. Për të siguruar se raportohet sipas obligimeve ligjore në fuqi.

**Fushëveprimi i auditimit:**

- Periudha: 01.01.2021 deri 30.11.2021

**1.7 Emërtimi i Auditimit:**

Të gjeturat:

Rekomandimet:

Përshkrim i shkurtër i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):


**1.8 Emërtimi i auditimit:**


Te gjeturat:


Rekomandimet:

Përshkrimi i shkurtër i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

|                                                                                                                                                                                                                  |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>1.9 Emërtimi i auditimit:</b>                                                                                                                                                                                 |
| Të gjeturat:                                                                                                                                                                                                     |
| Rekomandimet:                                                                                                                                                                                                    |
| Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):                                                                                                                           |
| <b>1.10 Emërtimi i auditimit:</b>                                                                                                                                                                                |
| Të gjeturat:                                                                                                                                                                                                     |
| Rekomandimet:                                                                                                                                                                                                    |
| Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):                                                                                                                           |
| <b>2. Rastet e moszbatimit ose zbatimit të gabuar të ligjit dhe dispozitave tjera ligjore, dhe dyshimeve për mashtrim</b>                                                                                        |
| 2.1 Thekso shkurtimisht rastet e mos përmbajtjes ose zbatimit të gabuar të ligjeve dhe dispozitave tjera dhe dyshimit të mashtrimit të vërtetuara gjatë kryerjes së auditimit:                                   |
| <b>3. Aktivitetet të cilat i ka ndërmarrë Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik me qëllim të zbatimit të rekomandimeve të rëndësishme, si dhe moszbatimin e rekomandimeve të rëndësishme</b>                 |
| 3.1 Shkurtimisht thekso aktivitetet e rëndësishme të cilat i ka ndërmarrë Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik me qëllim të zbatimit të rekomandimeve nga raportet e auditimit:                             |
| 3.2 Shkurtimisht përshkruaj rekomandimet e rëndësishme nga raportet e auditimit të cilat nuk janë zbatuar:                                                                                                       |
| <b>4. Përfundimet kryesore të cilat kanë të bëjnë me funksionimin e sistemit financiar dhe të kontrollit, si dhe rekomandimet e dhëna me qëllim të përmirësimit të afarizmit të subjektit të sektorit publik</b> |
| <b>5. Propozimet për zhvillimin e auditimit të brendshëm</b>                                                                                                                                                     |
| 5.1 Theksoni shkurtimisht aktivitetet të cilat janë planifikuar ose janë realizuar për zhvillimin e auditimit të brendshëm në subjektin tuaj të sektorit publik:                                                 |
| 5.2 Propozimet e juaja për zhvillim dhe përparim të auditimit të brendshëm (në përgjithësi)                                                                                                                      |
| <b>Komentet:</b>                                                                                                                                                                                                 |

  
 (Nënshkrimi i udhëheqësit të NjAB)  
 Fatmir Emini



  
 (Nënshkrimi i Udhëheqësit të SSP)  
 Dr. Qemajl Aliu